



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.546/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi - kryesues, Afjete Sada – Gillogjani dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Muhamet Shallti me vendbanim në Zvicër, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga Muhamet Shallti me vendbanim në Zvicër, i paraqitur kundër KQZ-së për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, **Urdhërohet** KQZ-ja, të përfshijë apeluesin në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Më datën 27.08.2021 PZAP-i, ka pranuar apelin nga Muhamet Shallti për shkak të mospërfshirjes së tij në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit, nga ana e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, me të cilin pretendendon se aplikimin e ka kryer me sukses sipas datës së caktuar. Ka bashkangjitur, formularin e aplikimit për votim jashtë vendit, kopjen e dokumentit të identifikimit të Republikës së Kosovës si dhe kopjen e konfirmimit nëpërmejt emailit nga KQZ-ja lidhur me pranimin e aplikacionit për regjistrim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën pretendon se: nga shkresat e lëndës shihet ushtruesi i ankesës, Muhamet Shallti ka dërguar aplikacionin për regjistrim së bashku me dokumentet mbështetëse brenda afatit të periudhës së aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës. Gjithashtu ka theksuar se gjatë procesit të shtypjes së aplikacioneve, për shkaqe teknike dhe gabimeve eventuale, aplikacioni për regjistrim dhe dokumentet mbështetëse nuk janë shtypur.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit, saktësishtë dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.546/2021 më datën 30.08.2021

Kryesues i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.